



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 dhe 61 të statutit të komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, duke u bazuar në masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarra më 11.03.2020 për parandalimin e përhapjes së Coronavirusit COVID-19, Sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, nxjerr;

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID19

Neni 1

Formohet komisioni i veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik COVID-19, në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Nexhmi Rudari , Nënkyetar i Komunës, | kryesues, |
| 2. Zaim Thaqi , drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, | anëtar |
| 3. Fahri Llugaliu , U.D. drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF, | anëtar |
| 4. Bedrie Rama , epidemiologe, në Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, | anëtare |
| 5. Vezir Januzi , drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, | anëtar |
| 6. Faik Muçiqi , drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, | anëtar |
| 7. Durim Salihu , drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, | anëtar |
| 8. Bekim Zogiani , Komandant i Stacionit të Policisë - Podujevë, | anëtar |
| 9. Mensur Hoti , kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame – Podujevë, | anëtar |
| 10. Donjeta Sheqiri , kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal – Podujevë, | anëtare |

Neni 2

Komisioni ndërmerr veprime dhe masa e nevojshme në përputhje me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në përputhje me Udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë lidhur me masat preventive për parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19, si dhe veprime dhe masa tjera varësisht situatave eventuale të krijuara.

Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit, dhe me të njëjtin njoftohen anëtarët dhe gjithë mekanizmat relevant të nivelit qendror dhe lokal.

Nr.02-020/04-0019708/20
Podujevë,
13 mars 2020

REPUBLICA E KOSOVES
OPSTINA PODUEVO
KOMUNA E PODUEVES
Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari